

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **217-25-5993-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001** për nevojat e FSK-së

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

SSI LOG L.L.C

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr: Tabir Zajmi - p.n

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)(Kodi postar)

044537903

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Arjeta Qebaja Sbkodra

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ssiillog@gmail.com

(Adresa elektronike)

25.06.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrorj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkëngjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Sbëno të dhënat si në vijim:

Shkumbin Asllani, Avokat nga INLEX Law Firm

(Emri i avokatit)

Rruga "Mark Isaku" L1/A5, 10000 Prishtinë

(Adresa e plotë)

+38344366007


(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

shkumbin.asllani@inlexpartners.com

(Adresa elektronike)

25.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

8 korrik 2025 - është publikuar tenderi
3 dhjetor 2025 - ka qenë afati i mbylljes së tenderit
20 shkurt 2026 - jemi rekomanduar për kontratë
27 shkurt 2026 - ka pasur kërkesa për rishqyrtim
24 prill 2026 - është publikuar Vendimi i OSHP-së
10 qershor 2026 - kemi pranuar vendimin për rekomandim
11 qershor 2026 - na është lejuar qasje në dokumente
15 qershor 2026 - kemi dërguar kërkesën për rishqyrtim
17 qershor 2026 - kemi pranuar vendimin për refuzim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenet 1, 7, 59, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Nenet 4, 6, 8, 47, 48, 52 dhe 134 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejtari fën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtroese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përsbkeruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. FAKTET E RASTIT

- 1.1. Ministria e Mbrojtjes, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ("AK"), ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull "Ritender – Furnizim me jelek taktik – SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së", me numër të prokurimit 217-25-5993-1-1-1 ("Tenderi"). Në lidhje me këtë tender, më 8 korrik 2025 AK kishte publikuar njoftimin për kontratë ndërsa kishte përcaktuar si afat për dorëzim të ofertave datën 3 dhjetor 2025.
- 1.2. Duke vepruar sipas këtij afati dhe duke qenë se i plotësonte të gjitha kushtet e tenderit, SSI LOG L.L.C. ("SSI LOG") kishte marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe kishte dorëzuar ofertën e saj në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë. Pas përfundimit të

procesit të vlerësimit, më 20 shkurt 2026, AK kishte publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit kishte rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik SSI LOG.

- 1.3. Kundër këtij vendimi operatorët e tjerë ekonomik kishin paraqitur kërkesa për rishqyrtim dhe më pas ankesa pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (“OSHP”) nga disa operatorë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, përkatësisht Hasan Gjesha B.I., RUNWAY SH.P.K., Fitim R. Bilalli B.I. dhe PI ER Technical Kft Branch in Kosovo. Në ankesat e tyre, operatorët ekonomik kishin kundërshtuar përgjegjshmërinë e ofertës së SSI LOG, duke pretenduar se e njëjta nuk i plotësonte kërkesat teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.
- 1.4. Pas shqyrtimit të ankesave, OSHP, me Vendimin nr. 2026/0132, 2026/0136, 2026/0141 dhe 2026/0144 të datës 24 prill 2026, i aprovoi pjesërisht ankesat e operatorëve ekonomikë ankues, anuloi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20 shkurt 2026 dhe e ktheu lëndën në rivlerësim pranë Ministrisë së Mbrojtjes.
- 1.5. Si rrjedhojë, pas rivlerësimit të ofertave, AK kishte nxjerrë një vendim të ri, i cili iu komunikua SSI LOG më 10 qershor 2026. Në këtë vendim, AK kishte konstatuar se oferta e SSI LOG nuk i përmbushte disa prej kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe, për pasojë, nuk e kishte rekomanduar për dhënie të kontratës. Më 11 qershor 2026, SSI LOG ka ushtruar të drejtën e qasjes në dokumentacionin e tenderit me qëllim të verifikimit të bazës faktike dhe juridike të vendimit të AK.
- 1.6. Në lidhje me këtë, pas shqyrtimit të dokumentacionit, SSI LOG e kishte kuptuar se AK e kishte eliminuar ofertën e saj me arsyetimin se kinse nuk i përmbushte kërkesat teknike dhe profesionale të tenderit, përkatësisht lidhur me testimet laboratorike të produktit të ofertuar dhe kriterin për kontrata të ngjashme në vlerë prej së paku 500,000.00 euro. Si rezultat, më 15 qershor 2026, SSI LOG kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.
- 1.7. Në kërkesën për rishqyrtim, SSI LOG kishte argumentuar se oferta e saj ishte ofertë e përgjegjshme dhe ekonomikisht më e favorshme, me çmim prej 240,000.00 euro, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë kishte ofertuar në vlerë prej 296,720.00 euro, respektivisht 56,720.00 euro më shtrenjtë. SSI LOG kishte theksuar se vendimi i AK-së bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë parimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe përdorimit racional të fondeve publike.
- 1.8. Lidhur me aspektin teknik, për të cilin ishte shpallur i papërgjegjshëm, SSI LOG kishte theksuar se raporti laboratorik i paraqitur gjatë ofertimit përmbante një lëshim teknik të laboratorit lidhur me referimin e standardit ISO 105-B02 në vend të ISO 105-B04. Thënë këtë, ky gabim nuk kishte të bënte me cilësinë apo karakteristikat e produktit të ofertuar, por vetëm me mënyrën e referimit të standardit në raport. Për më tepër, SSI LOG kishte vërtetuar se laboratorit kishte korrigjuar këtë lëshim dhe kishte lëshuar raport të përditësuar më 13 janar 2026, në të cilin përfshihej standardi ISO 105-B04, siç kërkohej nga Dosja e Tenderit. SSI LOG kishte argumentuar se një devijim i tillë përbënte devijim të vogël teknik, i cili nuk ndikonte në substancën e ofertës dhe nuk mund të shërbente si bazë për eliminimin e saj.
- 1.9. Po ashtu, në kërkesën për rishqyrtim, SSI LOG kishte kundërshtuar konstatimin e AK-së lidhur me

mungesën e përvojës së kërkuar profesionale. SSI LOG kishte dëshmuar realizimin e kontratave të ngjashme në vlerë të përgjithshme prej 708,949.82 euro, duke përfshirë furnizime me artikuj tekstili për organizata ndërkombëtare, institucione publike dhe Ministrinë e Mbrojtjes. Në lidhje me këtë, SSI LOG kishte theksuar se AK kishte bërë interpretim të gabuar të kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe kishte vlerësuar në mënyrë të padrejtë kontratat e paraqitura si referenca.

- 1.10. Me vendimin e datës 17 qershor 2026, Ministria e Mbrojtjes e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të SSI LOG. Në arsyetimin e saj, AK ka theksuar se gjatë rivlerësimit kishte vepruar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, kriteret e Dosjes së Tenderit dhe konstatimet e përfshira në vendimin e mëhershëm të OSHP-së. Për rrjedhojë, AK e kishte lënë në fuqi vendimin e datës 10 qershor 2026 dhe kishte autorizuar vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

2. PRETENDIMET E VENDIMIT

- 2.1. Ndonëse Kërkesa për Rishqyrtim ishte paraqitur mbi bazën e disa argumenteve në Vendimin e Apeluar është përmendur – në mënyrë të përgjithshme – se AK nuk ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik.
- 2.2. Ligji për Procedurën Administrative përcakton saktë se çfarë duhet të përfshijë arsyetimi i një akti administrativ. Përkatësisht, Neni 48 i Ligjit për Procedurën Administrative shprehimisht thekson se arsyetimi i aktit administrativ përfshinë: (i) paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; (ii) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; (iii) shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; (iv) bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; (v) shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; (vi) në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Të gjitha këto elemente e bëjnë një akt administrativ të plotë dhe të drejtë për palën.
- 2.3. Në lidhje me këtë, nëse shqyrtojmë Vendimin e Apeluar, mund të kuptojmë se të njëjtit i mungon pjesa më e madhe e këtyre elementeve ligjore të cilat nuk janë opsionale, por janë të detyrueshme për secilin akt administrativ. Përkatësisht, në Vendimin e Apeluar nuk është vendosur situata faktike mbi të cilën është marrë vendimi, nuk janë shënuar shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, nuk është shënuar baza ligjore e vendimit as arsyeja se pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet përse nuk është pranuar ndonjëri nga argumentet e palës, dhe as mënyra e ushtrimit të diskrecionit. Madje, në Vendimin e Apeluar nuk janë shënuar as pretendimet ankimore të SSI Log.
- 2.4. Në Vendimin e Apeluar është dhënë vetëm ky konstatim: *“Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë...”*, pa u trajtuar dhe pa u analizuar asnjëri prej pretendimeve të paraqitura nga SSI Log. Një arsyetim i tillë është i pamjaftueshëm për të përmbushur standardin ligjor të arsyetimit të një akti administrativ. SSI Log ka të drejtë të njoftohet qartë për arsyet e refuzimit të kërkesës së saj. Kjo mund të realizohet vetëm përmes shqyrtimit të secilit pretendim veç e veç dhe dhënies së arsyeve faktike dhe juridike se përse ai konsiderohet i pabazuar. Mosveprimi në këtë mënyrë e privon SSI Log nga e drejta për të kuptuar bazën e vendimmarrjes dhe për të ushtruar në mënyrë efektive mjetet juridike. Për rrjedhojë, është e qartë se AK ka nxjerrë Vendimin e Apeluar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit për Procedurën Administrative lidhur me detyrimin për arsyetimin e vendimeve

administrative.

- 2.5. Për më tepër, Neni 134, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se, krahas kërkesave të Nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën duhet të përmbajë edhe vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala. Në rastin konkret, Vendimi i Apeluar nuk përmban asnjë vlerësim individual mbi pretendimet e SSI LOG lidhur me kontratat e ngjashme, raportin laboratorik ISO 105-B04:2014 apo mospërputhjet teknike të operatorëve ekonomikë të rekomanduar. Për rrjedhojë, Vendimi i Apeluar është nxjerrë në kundërshtim edhe me Nenin 134 të LPPA-së.

3. ARGUMENTET E PATRAJTUARA

- 3.1. Ashtu siç u shpjegua më sipër, AK nuk ka trajtuar asnjë argument të SSI Log me rastin e nxjerrjes së Vendimit të Apeluar. Si rrjedhojë e kësaj, SSI Log detyrohet që edhe një herë t'i paraqes argumentet e veta në lidhje me atë se përse SSI Log plotëson kushtet e tenderit dhe do të duhej të shpallej si operatori ekonomik fitues.

Mos-pranimi i ofertës më të lirë

- 3.2. AK ka eliminuar ofertën e SSI LOG, ndonëse e njëjta është ofertë e përgjegjshme, i përmbush të gjitha kërkesat kualifikuese dhe teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, si dhe paraqet çmimin më të ulët prej EUR 240,000.00. Në të njëjtën kohë, AK ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik me çmim prej EUR 296,720.00, i cili përveç që nuk plotëson specifikat e tenderit ka ofertë EUR 56,720.00 më të lartë se oferta e SSI LOG.
- 3.3. Në lidhje me këtë, është me rëndësi të theksohet se qëllimi themelor i procedurave të prokurimit publik është sigurimi i vlerës më të mirë për parandë publike, përmes konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Prandaj, edhe në dosje të tenderit, si kusht është vendosur oferta më e përshtatshme ekonomikisht. Nga kjo, përderisa oferta e SSI LOG i plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, eliminimi i saj dhe rekomandimi i një oferte dukshëm më të shtrenjtë cenon drejtpërdrejt interesin publik dhe bie ndesh me parimet bazë mbi të cilat mbështetet sistemi i prokurimit publik.
- 3.4. Për më tepër, AK nuk ka arsyetuar përse oferta e SSI LOG është konsideruar e papërgjegjshme, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar është vlerësuar si i përgjegjshëm, pavarësisht mospërputhjeve të evidentuara në dokumentacionin dhe mostrën e tij. Në këto rrethana, vendimi i AK-së ka përzgjedhur një ofertë që ngarkon buxhetin publik me një çmim shtesë prej **EUR 56,720.00** pa asnjë bazë. Prandaj, duke zgjedhur një operator ekonomik me ofertë dukshëm më të lartë, i cili përveç çmimit nuk plotëson as kushtet e tenderit, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit për Prokurim Publik, i cili obligon autoritetet kontraktuese që, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të sigurojnë përdorim efikas, ekonomik dhe racional të fondeve publike, si dhe të arrijnë rezultatin më të favorshëm për interesin publik.

Përmbushja e kërkesës për realizimin e punëve të ngjashme

- 3.5. AK ka konstatuar gabimisht se SSI LOG nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës për realizimin e

kontratave të ngjashme në vlerë minimale prej 500,000.00 euro. Një konstatim i tillë nuk mbështetet në faktet e çështjes dhe në dokumentacionin e dorëzuar në ofertë. Në dokumentacionin e ofertës, SSI LOG ka paraqitur kontrata, referenca dhe dëshmi, nga të cilat vërtetohet se gjatë periudhës së kërkuar ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme në vlerë të përgjithshme prej **EUR 708,949.82**, duke tejkaluar dukshëm prapun minimal të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

- 3.6. Përkatësisht, SSI LOG ka dëshmuar: (i) realizimin e kontratave me IOM në vlerë të përgjithshme prej **EUR 501,628.00**; (ii) realizimin e kontratës “Baby Box” me Komunën e Kamenicës në vlerë prej **EUR 78,256.00**; (iii) realizimin e kontratës me Ministrinë e Mbrojtjes për furnizim me batanije në vlerë prej **EUR 129,065.82**. Të gjitha kontratat e lartcekura kanë të bëjnë me furnizime të produkteve tekstile dhe, për nga natyra, objekti dhe lloji i furnizimeve, përbëjnë kontrata të ngjashme me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit.
- 3.7. Për më tepër, është e qartë se Kërkesa e Dosjes së Tenderit për realizimin e kontratave të ngjashme nuk mund të interpretohet si kërkesë për realizimin e kontratave identike me furnizimin konkret të jelekëve taktikë. Ngjashmëria duhet të vlerësohet sipas natyrës së furnizimit, llojit të produkteve, kërkesave të cilësisë, organizimit të furnizimit dhe kapacitetit të operatorit ekonomik për realizimin e kontratave të tilla. Kontratat e paraqitura nga SSI LOG lidhen me furnizimin e artikujve tekstilë dhe produkteve të ngjashme për nga natyra e furnizimit dhe, së bashku, tejkalojnë dukshëm prapun minimal prej EUR 500,000.00 të kërkuar në Dosjen e Tenderit. AK nuk ka dhënë asnjë arsytim konkret se cilat elemente të ngjashmërisë mungojnë në secilën prej kontratave të paraqitura nga SSI LOG. Konstatimi i përgjithshëm se kriteri nuk është përmbushur nuk mjafton, pa identifikuar kontratën përkatëse, vlerën e papranuar dhe arsyen konkrete pse ajo nuk konsiderohet e ngjashme. Për rrjedhojë, eliminimi i SSI LOG për këtë arsye është i paarsyetuar dhe në kundërshtim me Nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përmbushja e kërkesës ISO 105-B04:2014 dhe karakteri formal i lëshimit në raportin laboratorik

- 3.8. AK ka konstatuar se SSI LOG nuk e ka përmbushur kërkesën teknike lidhur me standardin ISO 105-B04:2014, duke u mbështetur në raportin testues të dorëzuar me ofertë. Megjithatë, një konstatim i tillë nuk qëndron dhe nuk pasqyron gjendjen faktike. Nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës rezulton se produkti i ofertuar është testuar nga laboratorit, mirëpo në raportin fillestar të testimit, për shkak të një lëshimi teknik të laboratorit, është shënuar standardi ISO 105-B02:2014 në vend të standardit ISO 105-B04:2014. Pas kërkesës për verifikim dhe sqarim, vetë laboratorit e ka konfirmuar gabimin dhe ka lëshuar raportin e korrigjuar më datë 13.01.2026, duke vërtetuar se testimi është kryer sipas standardit të kërkuar ISO 105-B04:2014. Raporti i korrigjuar i datës 13.01.2026 nuk paraqet testim të ri të kryer pas afatit për dorëzimin e ofertave, por korrigjim të referencës së standardit në raportin fillestar për testimin e kryer më datë 23 tetor 2025. Kjo vërtetohet nga deklarata e laboratorit, numri identifikues i mostrës, regjistri i pranimit të mostrës dhe të dhënat bazë të testimit, të cilat dëshmojnë se raporti i korrigjuar lidhet me të njëjtën mostër dhe të njëjtin proces testimi si raporti fillestar.
- 3.9. Në lidhje me këtë, është me rëndësi të theksohet se korrigjimi i raportit nuk ka sjellë asnjë ndryshim në produktin e ofertuar, në karakteristikat e tij teknike apo në rezultatet e testimit. Produkti ka mbetur i njëjtë, ndërsa është korrigjuar vetëm referenca e standardit e paraqitur në

raport. Si rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me mungesë të testimi, mungesë të dokumentacionit apo mospërbushje të kërkesave teknike, por vetëm me korrigjimin e një gabimi teknik të bërë nga laboratorit.

- 3.10. Për më tepër, vetë AK ka kërkuar sqarime lidhur me këtë çështje, gjë që tregon se kemi të bëjmë me një rrethanë që mund të verifikohet dhe sqarohet pa cenuar parimet e konkurrencës apo pa ndryshuar përmbajtjen substanciale të ofertës. Në këto rrethana, AK ka pasur mundësi që, në pajtim me Nenin 59, paragrafi 2, të Ligjit për Prokurim Publik, të kërkojë sqarim me shkrim lidhur me raportin laboratorik, pa kërkuar dhe pa pranuar ndryshim material të ofertës. Për më tepër, Neni 59, paragrafi 4, parasheh që një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm kur përmban vetëm gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material të tenderit, apo devijime të vogla që nuk shkaktojnë ndryshim material nga kërkesat e Dosjes së Tenderit. Përkatesisht, Neni 59, paragrafi 4 i Ligjit për Prokurim Publik shprehimisht parasheh se “[...] **autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysht gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.**” Në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Prokurim Publik, lëshimi teknik është adresuar, sqaruar dhe eliminuar.
- 3.11. Pavarësisht kësaj, AK ka trajtuar si mospërbushje materiale të kriterit teknik një çështje që në thelb përbën vetëm një lëshim formal në raportim, ndonëse përputhshmëria e produktit me standardin ISO 105-B04:2014 është vërtetuar nga vetë laboratorit përkatës. Mbi këtë bazë, është e qartë se AK ka eliminuar SSI Log në kundërshtim me Nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik.

Mungesa e dëshmisë për akreditimin e laboratorit

- 3.12. Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht që raportet testuese të jenë të lëshuara nga laboratorit të akredituar. Kjo kërkesë nuk është vendosur pa qëllim, por synon të sigurojë që testimet të kryhen nga institucione që kanë kompetencën teknike, pajisjet, procedurat dhe personelin e nevojshëm për kryerjen e testeve përkatëse sipas standardeve ndërkombëtare.
- 3.13. Megjithatë, Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që laboratorit i cili ka lëshuar raportet testuese është laboratorit i akredituar për kryerjen e testeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Përkatesisht, nuk janë dorëzuar: (i) Certifikata e akreditimit të laboratorit; (ii) Fushëveprimi i akreditimit (Scope of Accreditation); (iii) Dëshmi se metodat e testimi të përdorura për raportet e paraqitura mbulohen nga akreditimi i laboratorit. Përkundrazi, dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar kanë të bëjnë me akreditimin institucional të Universitetit Hacettepe dhe me autorizimet apo akreditimet e programeve studimore të këtij institucioni. Këto dokumente nuk dëshmojnë në asnjë mënyrë se laboratorit që ka kryer testimet është i akredituar për kryerjen e analizave laboratorike në fushën e tekstilit.
- 3.14. Akreditimi i një universiteti ose i programeve të tij akademike nuk është i njëjtë dhe nuk mund të zëvendësojë akreditimin e laboratorit sipas standardit **TS EN ISO/IEC 17025**, i cili është

standardi ndërkombëtar që dëshmon kompetencën teknike të laboratorëve për kryerjen e testimeve dhe kalibrimeve. Behet fjalë për procese krejtësisht të ndryshme, të cilat kanë objekt vlerësimi dhe qëllim të ndryshëm. Për rrjedhojë, OE i rekomanduar nuk ka arritur të dëshmojë se raportet testuese mbi të cilat mbështetet oferta e tij janë lëshuar nga një laborator i akredituar, ashtu siç është kërkuar nga Dosja e Tenderit. Në mungesë të këtyre dëshmive, AK nuk ka pasur bazë ligjore që t'i konsiderojë raportet testuese si të pranueshme dhe as të konstatojë përmbushjen e kërkesave teknike nga ana e këtij operatori ekonomik. Pranimi i një oferte që nuk përmbush një kërkesë të tillë të qartë të Dosjes së Tenderit cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe bie ndesh me nenet 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurim. Për këtë arsye, oferta e OE të rekomanduar është dashur të vlerësohet si e papërgjegjshme.

Mungesa e testeve të detyrueshme për materialin coated/laminated

- 3.15.** Dosja e Tenderit ka përcaktuar qartë se materiali bazë i kërkuar për produktin është 1000D Cordura® Nylon 6.6 ose ekuivalent, ndërsa ka lejuar edhe përdorimin e materialeve coated/laminated, me kusht që operatori ekonomik të paraqesë raportet shtesë të testimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Përkatesisht, në specifikimet teknike është përcaktuar shprehimisht se në rast se ofrohen materiale coated ose laminated, operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit sipas standardeve: ISO 1421, ISO 4674, ISO 2411.
- 3.16.** Nga dokumentacioni i ofertës dhe nga ekzaminimi fizik i mostrës së paraqitur nga OE i rekomanduar rezulton se materiali i ofertuar nuk përbëhet vetëm nga Cordura 1000D apo Nylon 6.6, por në pjesën e brendshme përmban edhe një shtresë shtesë PU/PVC coated/laminated, e cila shërben për rritjen e rezistencës ndaj depërtimit të ujit. Vetë ekzistimi i kësaj shtrese aktivizon detyrimin për paraqitjen e testeve shtesë të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Kjo për arsye se performanca teknike e materialit coated/laminated nuk mund të vlerësohet vetëm përmes testeve bazë të materialit tekstil, por duhet të verifikohet edhe përmes testeve specifike që matin rezistencën, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e lidhjes ndërmjet shtresës së laminuar dhe materialit bazë.
- 3.17.** Pavarësisht kësaj, OE i rekomanduar nuk ka paraqitur raportet testuese të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues për materialet coated/laminated. Për pasojë, mungojnë dëshmitë që do të vërtetonin se materiali i ofertuar i përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Veçanërisht, mungesa e testit ISO 2411 ka rëndësi thelbësore, pasi ky test mat forcën e ngjitjes ndërmjet shtresës PU/PVC dhe materialit bazë, element ky që ndikon drejtpërdrejt në performancën, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e produktit.
- 3.18.** Në këto rrethana, AK nuk ka pasur bazë ligjore që të konstatojë përmbushjen e kërkesave teknike nga ana e OE të rekomanduar. Meqenëse një kërkesë e qartë dhe e detyrueshme e Dosjes së Tenderit nuk është përmbushur dhe nuk janë dorëzuar raportet e kërkuara të testimit, oferta e OE të rekomanduar është dashur të vlerësohet si e papërgjegjshme në pajtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurim.

Mungesa e dy aksesoreve të detyrueshëm "Quick Release Side Buckles"

- 3.19.** Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar qartë se produkti duhet

të përfshijë, ndër të tjera: “Two (2) quick-release side buckles” Kjo kërkesë është pjesë e specifikimeve teknike obligative dhe nuk është paraparë si element fakultativ apo opsional. Për rrjedhojë, secili operator ekonomik ka qenë i obliguar të ofrojë një produkt që përmban të gjithë komponentët dhe aksesoret e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

- 3.20. Nga ekzaminimi fizik i mostrës së paraqitur nga OE i rekomanduar rezulton se dy aksesoret “quick-release side buckles” mungojnë. Kjo mospërputhje është lehtësisht e verifikueshme nga vetë mostra dhe nuk kërkon interpretim teknik apo vlerësim subjektiv. Mungesa e këtyre aksesoreve nuk përbën një lëshim formal apo devijim të vogël teknik, por paraqet mospërmbushje të drejtpërdrejtë të një kërkesë të shprehur të Dosjes së Tenderit. Kjo për arsye se aksesoret në fjalë janë pjesë përbërëse e produktit të kërkuar dhe ndikojnë në funksionalitetin e tij, konkretisht në mundësinë e lidhjes dhe shkëputjes së shpejtë të sistemit me pajisjet përkatëse mbrojtëse.
- 3.21. Përderisa Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht që produkti të furnizohet me dy (2) “quick-release side buckles”, ndërsa mostra e OE të rekomanduar nuk i përmban këta komponentë, rezulton se produkti i ofertuar nuk është në përputhje me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Si pasojë e kësaj, oferta e OE të rekomanduar është dashur të vlerësohej si e papërgjegjshme, pasi nuk e përmbush një nga kërkesat teknike të detyrueshme të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Mospërputhja e xhepave anësorë (Additional Pouches) me specifikimet teknike

- 3.22. Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar qartë karakteristikat teknike që duhet t'i përmbushin xhepat anësorë (Additional Pouches). Përkatësisht, është kërkuar që produkti të përmbajë dy xhepa anësorë të integruar në panel, të përshtatshëm për vendosjen e radio-ve, GPS-ve ose pajisjeve të ngjashme, me dimensione 20 cm lartësi dhe 10 cm gjerësi, si dhe me sistem mbyllje me velcro ose elastic.
- 3.23. Në lidhje me këtë, nga ekzaminimi fizik i mostrës së paraqitur nga OE i rekomanduar rezulton se produkti i ofertuar nuk i përmbush këto kërkesa në disa aspekte thelbësore. Së pari, xhepat e ofruar nuk janë të integruar në panel, ashtu siç kërkohet në specifikimet teknike, por janë xhepa të montueshëm (MOLLE pouches), të cilët mund të hiqen dhe të vendosen veçmas. Kjo paraqet devijim nga konfigurimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Së dyti, matjet e realizuara tregojnë se dimensionet e xhepave të ofruar janë afërsisht 24 cm x 12 cm, ndërsa specifikimet teknike kërkojnë dimensione 20 cm x 10 cm, me tolerancat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, siç dëshmohet në Shtojcën nr. 1 dhe Shtojcën nr. 2 të kësaj Ankese. Rrjedhimisht, dimensionet e xhepave tejkalojnë dukshëm kufijtë e lejuar. Së treti, sistemi i mbylljes i ofruar nuk është me velcro ose elastic, siç kërkohet shprehimisht nga Dosja e Tenderit, por me sistem mbylljeje me adapter (buckle). Kjo paraqet një tjetër mospërputhje të drejtpërdrejtë me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues.
- 3.24. Për rrjedhojë, mostra e OE të rekomanduar nuk i përmbush specifikimet teknike lidhur me xhepat anësorë, si për nga konfigurimi, ashtu edhe për nga dimensionet dhe sistemi i mbylljes. Në këto rrethana, oferta nuk ka mundur të konsiderohet e përgjegjshme në kuptim të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik.

- 3.25. Dosja e Tenderit ka përcaktuar se xhëpat për karikatorë duhet të jenë të dimensionuar sipas standardit për karikatorët 5.56 mm dhe 7.62 mm NATO, me gjerësi rreth 8 cm, duke lejuar vetëm tolerancat e përcaktuara në specifikimet teknike. Gjatë ekzaminimit të mostrës së paraqitur nga OE i rekomanduar janë kryer matje fizike të xhëpave të karikatorëve, nga të cilat rezulton se gjerësia e tyre është 7.5 cm. Matjet të shoqëruara me fotografi janë paraqitur në Shtojcën nr. 1 dhe Shtojcën nr. 2 të kësaj Ankese.
- 3.26. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar vetë dimensionet dhe tolerancat e pranueshme në Dosjen e Tenderit, ndërsa operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar t'i përmbushin ato gjatë përgatitjes së mostrave dhe ofertave të tyre. Për rrjedhojë, vlerësimi duhet të bëhet mbi bazën e përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara dhe jo mbi bazën e supozimeve se devijimi mund të jetë i pranueshëm. Është me rëndësi të theksohet se AK ka zbatuar standard të ndryshëm vlerësimi ndaj SSI LOG dhe operatorëve ekonomikë të rekomanduar. Në raport me SSI LOG, AK ka trajtuar si mospërmbushje materiale një gabim të pretenduar në referimin e standardit laboratorik, ndonëse çështja ishte objekt sqarimi dhe verifikimi. Ndërsa, në raport me operatorët e rekomanduar, AK ka pranuar oferta pavarësisht mungesës së dëshmive për akreditimin e laboratorit, mungesës së testeve të detyrueshme për materialet coated/laminated, mungesës së aksesorëve të detyrueshëm dhe devijimeve nga dimensionet e kërkuara të mostrave. Një qasje e tillë paraqet zbatim selektiv të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës sipas Nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik. Rrjedhimisht, mostra e OE të rekomanduar nuk përputhet plotësisht me dimensionet e kërkuara për xhëpat e karikatorëve dhe për këtë arsye oferta nuk është dashur të vlerësohet si ofertë e përgjegjshme.

Devijimet dimensionale të mostrës së OE RUNWAY SH.P.K.

- 3.27. Dosja e Tenderit ka përcaktuar qartë dimensionet e kërkuara për xhëpat anësorë, xhëpat e karikatorëve dhe xhëpat e brendshëm, duke përcaktuar gjithashtu tolerancat maksimale të lejuara. Këto kërkesa janë pjesë e specifikimeve teknike obligative dhe përbëjnë bazën mbi të cilën vlerësohet përputhshmëria e produktit të ofertuar.
- 3.28. Nga matjet e realizuara gjatë ekzaminimit të mostrës së paraqitur nga OE RUNWAY SH.P.K. rezulton se një numër i konsiderueshëm i elementeve të produktit devijojnë nga dimensionet e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Përkatësisht:
- Xhëpat anësorë për radio/GPS janë kërkuar me dimensione 20 cm x 10 cm, ndërsa në mostër janë konstatuar dimensione 20 cm x 13 cm, përkatësisht tejkalim i gjerësisë për 3 cm;
 - Xhëpat e karikatorëve janë kërkuar me gjerësi rreth 8 cm, ndërsa matjet tregojnë gjerësi prej 9 cm;
 - Xhëpat e brendshëm anësorë janë kërkuar me gjerësi 25 cm \pm 2 cm, ndërsa në mostër janë konstatuar me gjerësi 21 cm;
 - Xhëpi i brendshëm qendror është kërkuar me gjerësi 30 cm \pm 2 cm, ndërsa në mostër është konstatuar me gjerësi 36 cm.
- 3.29. Nga këto matje shihet se devijimet e konstatuara nuk janë të izoluara, por paraqiten në disa

komponentë të ndryshëm të produktit dhe në raste të caktuara tejkalojnë dukshëm tolerancat e lejuara nga Autoriteti Kontraktues. Përkundër këtyre mospërputhjeve me specififikimet teknike, AK e ka konsideruar ofertën e OE RUNWAY SH.P.K. si ofertë të përgjegjshme. Një vlerësim i tillë nuk mbështetet në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe krijon trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë, veçanërisht duke pasur parasysh se oferta e SSI LOG është eliminuar për arsye dukshëm më pak të rëndësishme dhe të natyrës teknike. Mbi këtë bazë është e qartë se mostra e OE RUNWAY SH.P.K. nuk përmbush specififikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe oferta e këtij operatori nuk është dashur të vlerësohej si ofertë e përgjegjshme.

Mungesa e testit të detyrueshëm ISO 2411

- 3.30. Nga raportet laboratorike të paraqitura nga OE RUNWAY SH.P.K., si dhe nga ekzaminimi i mostrës së dorëzuar, vërtetohet se materiali i përdorur për prodhimin e produktit përmban shtresë shtesë PU/PVC coated/laminated, e aplikuar në pjesën e brendshme të materialit bazë. Vetë Dosja e Tenderit ka paraparë shprehimisht se në rastet kur ofrohen materiale coated ose laminated, operatori ekonomik është i obliguar të paraqesë raportet shtesë të testimit sipas standardeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, përfshirë edhe testimin sipas standardit ISO 2411. Qëllimi i këtij testi është verifikimi i forcës së ngjitjes ndërmjet shtresës PU/PVC dhe materialit bazë, element i cili ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë, rezistencën dhe performancën e produktit gjatë përdorimit.
- 3.31. Pavarësisht kësaj, nga dokumentacioni i ofertës kuptohet se OE RUNWAY SH.P.K. nuk ka paraqitur raport testues sipas standardit ISO 2411, pavarësisht se materiali i ofertuar përmban shtresë coated/laminated dhe rrjedhimisht i nënshtrohet kësaj kërkesë të Dosjes së Tenderit. Përderisa Autoriteti Kontraktues ka paraparë shprehimisht paraqitjen e këtij testi si kusht për pranueshmërinë e materialeve coated/laminated, mungesa e tij nuk mund të konsiderohet si lëshim formal apo çështje e parëndësishme. Në mungesë të këtij raporti testues, nuk ekziston asnjë dëshmi objektive që materiali i ofertuar përmbush parametrat teknikë të kërkuar me Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, OE RUNWAY SH.P.K. nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e plotë të kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, dhe për këtë arsye oferta e tij është dashur të vlerësohej si e papërgjegjshme në pajtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurim.

4. DISPOZITAT LIGJORE TË SHKELURA

- 4.1. Me veprimet dhe mosveprimet e tij, Autoriteti Kontraktues ka shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë, të përsëritur dhe kumulative dispozitat vijuese, të cilat janë elaboruar detajisht në Kërkesën e Dytë për Rivlerësim:

Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës: Nenin 1, Nenin 7, Nenin 59.

Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: Nenin 4, Nenin 6, Nenin 8, Nenin 47, Neni 48, dhe Nenin 52 dhe Neni 134

- 4.2. Në kuptim të Nenit 1 të LPP-së, qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Ky parim është një detyrim ligjor që duhet të reflektohet në çdo vendim të Autoritetit Kontraktues. Në këtë çështje, Autoriteti

Kontraktues, edhe pas rivlerësimit, ka ruajtur të njëjtin rezultat dhe ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik me çmim prej 296,720.00 euro, ndonëse oferta e SSI LOG në vlerë prej 240,000.00 euro është 56,720.00 euro më e ulët dhe i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit. Për pasojë, vendimi i kontestuar jo vetëm që cenon të drejtat e SSI LOG si operator ekonomik, por njëkohësisht bie ndesh me detyrimin ligjor për përdorim racional dhe ekonomik të fondeve publike.

- 4.3. Neni 7.1 i LPP-së përcakton se autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, jodiskriminuese dhe transparente. Ky detyrim nënkupton se të njëjtat kritere dhe standard të vlerësimit duhet të aplikohen ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Pavaresisht kesaj, Autoriteti Kontraktues ka aplikuar standarde të ndryshme vlerësimi ndaj SSI LOG dhe operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë. Derisa oferta e SSI LOG është eliminuar për shkak të një lëshimi formal në raportin laboratorik, i cili është sqaruar dhe korrigjuar nga vetë laboratorit pa ndryshuar karakteristikat teknike të produktit, tek operatorët ekonomikë të rekomanduar janë toleruar mospërputhje materiale dhe teknike që lidhen me përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kushteve të Dosjes së Tenderit.
- 4.4. Veprimet e Autoritetit Kontraktues janë gjithashtu në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së, i cili përcakton se një ofertë mund të konsiderohet e përgjegjshme vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Siç është argumentuar në mënyrë të detajuar në këtë ankesë, operatorët ekonomikë të rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin një numër të konsiderueshëm të kërkesave teknike dhe kualifikuese, përfshirë mungesën e dëshmive për akreditimin e laboratorit, mungesën e testeve të detyrueshme për materialet coated/laminated, mospërputhjet dimensionale të mostrave, mungesën e komponentëve të detyrueshëm të produktit dhe mangësi të tjera të cilat nuk mund të konsiderohen devijime të vogla teknike.
- 4.5. Në aspektin teknik, mospërputhjet e evidentuara janë të shumta dhe substanciale. Tek operatori ekonomik i rekomanduar janë konstatuar mungesa të dokumentacionit të kërkuar nga Dosja e Tenderit, përfshirë mungesën e dëshmive për akreditimin e laboratorit dhe mungesën e testeve të detyrueshme ISO 1421, ISO 4674 dhe ISO 2411 për materialet coated/laminated. Po ashtu, mostra e paraqitur nuk përmbush një sërë kërkesash teknike lidhur me dimensionet e xhepave anësorë, xhepave të karikatorëve, xhepave të brendshëm dhe aksesorëve të detyrueshëm të produktit. Përkundër këtyre mospërputhjeve, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën si të përgjegjshme, duke vepruar në kundërshtim me kriteret që vetë i ka përcaktuar në Dosjen e Tenderit.
- 4.6. Të gjitha shkeljet e sipërpërmendura është dashur të adresoheshin në mënyrë të plotë dhe konkrete në Vendimin e Apeluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar asnjërin prej pretendimeve të ngritura nga SSI LOG dhe nuk ka dhënë asnjë analizë faktike apo juridike lidhur me to. Ndonëse Neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative kërkon që arsyetimi i një akti administrativ të përmbajë paraqitjen e fakteve relevante, vlerësimin e provave, bazën juridike të vendimit dhe arsyet për refuzimin e pretendimeve të palës, Vendimi i Apeluar përmban vetëm konstatime të përgjithshme dhe formale, pa adresuar asnjë prej çështjeve konkrete të ngritura në kërkesën për rivlerësim.
- 4.7. Mbi bazën e të gjitha argumenteve dhe provave të paraqitura në këtë ankesë vërtetohet se

operatorët ekonomikë të rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk është dashur të konsiderohen operatorë të përgjegjshëm. Në të njëjtën kohë, oferta e SSI LOG është eliminuar në mënyrë të kundërligjshme, ndonëse i përmbush kërkesat kualifikuese dhe teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Për rrjedhojë, pranimi i ofertave të operatorëve ekonomikë të rekomanduar dhe eliminimi i ofertës së SSI LOG është bërë në kundërshtim me nenet në kundërshtim me Nenet 1, 7 dhe 59 të LPP-së, si dhe Nenet 47, 48 dhe 134 të LPPA-së, si dhe me parimet themelore të procedurës administrative. Prandaj, Parashtruesi i Ankesës kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të veprë sipas kërkesave të paraqitura në dispozitivin e saj.


Dokumentet e Bashkëngjitura:

1. Shtojca Nr. 1: Tabela krahasuese e specifikimeve teknike të Dosjes së Tenderit dhe matjeve të kryera në mostrat e operatorëve ekonomikë të rekomanduar;
2. Shtojca nr. 2: Fotografitë e mostrave të operatorëve ekonomikë të rekomanduar, me shënimet përkatëse të matjeve;

Shtojca nr. 1:

Tabela krahasuese e specifikimeve teknike të Dosjes së Tenderit dhe matjeve të kryera në mostrat e operatorëve ekonomikë të rekomanduar dhe i përgjegjshëm;

OE / Mostra	Elementi	Kërkesa e DT-së	Toleranca	Matja e konstatuar	Devijimi	Foto
OE i rekomanduar	Xhepat anësorë	20 x 10 cm	[sipas DT-së]	24 x 12 cm	+4 cm / +2 cm	Foto 1
OE i rekomanduar	Xhep karikatori	rreth 8 cm	[sipas DT-së]	7.5 cm	-0.5 cm	Foto 2
OE i rekomanduar	Kerkesat e aksesoreve	Fotot e aksesoreve të kerkuara/			Mungojne dy aksesor	Foto 3
OE i rekomanduar	Materiali i mostres :Nylon6.6 me shtrese te veshur PU	E lejuar me mbeshtetje te testimeve shtese ISO 1421, ISO 4674 dhe ISO 2411			Mungojne raportet testuese ISO 1421, ISO 4674 dhe ISO 2411	Foto 4
RUNWAY	Xhep radio/GPS	20 x 10 cm	[sipas DT-së]	20 x 13 cm	+3 cm gjerësi	Foto 5
RUNWAY	Xhep karikatori	rreth 8 cm	[sipas DT-së]	9 cm	+1 cm	Foto 5
RUNWAY	Xhep i brendshëm anësor	25 cm ± 2 cm	23–27 cm	21 cm	-2 cm nën minimum	Foto 6
RUNWAY	Xhep i brendshëm qendror	30 cm ± 2 cm	28–32 cm	36 cm	+4 cm mbi maksimum	Foto 7
RUNWAY	Materiali i mostres :Nylon6.6 me shtrese te veshur PU	E lejuar me mbeshtetje te testimeve shtese ISO 1421, ISO 4674 dhe ISO 2411			Mungon raporti testues ISO 2411	Foto 8



a) *Velcro*

b) *Elastic*

c) *Mostra me adapter mbyllës*

Foto 1:Foto e sistemit te mbylles xhepit anesore dhe dimensionet e mostres ku lartesia eshte 23cm




Foto 2- Matjet e xhepit te karikatorëve dhe gjerësia e matur eshte 7.5 cm .

 **ÖZYİĞİT**
te k s t i l
MAKİNE GIDA TURZ. İNŞ. VE PET.
ÜR. PAZ. SAN. VE TİC. LTD. ŞTİ.

Technical specifications:

Color: Multicam or as requested

MFG: Military Contractor

Model: TAP, Tactical Assault Panel

Measurement: One size fits most or as from CA requested

TAP Tactical Assault Panel Features:

Durable 1000 Denier Cordura Material

MIL-Spec Thread and Velcro

Heavy-duty YKK® zipper

Belt loops secure vest to web belt

Nylon Polyurethane coating (PU).

Built-in Pockets for Carrying Six Magazines 5.56 and 7.62 magazines (open-top magazine pouches), one (1) hand grenade pouch and two (2) other additional pouches on the top.
Two Additional Pockets to Accommodate Several Different Handheld Radios and a Pocket for a Global Positioning System (GPS) or Other Items

Allows for Compatible Pockets to be Connected, while Allowing for Quick-Release in Emergency Situations when worn with Compatible Body Armor

Users who wear the TAP independently of body armor may opt to use an external webbing harness and wear the TAP like a Ranger Assault Carrying Kit (RACK)

Highly Adjustable Y-Harness (NOT INCLUDED)

Water Repellent

Webbing on the exterior of the pouch for Modular Attachments

The shoulders on the vest should be adjusted with long velcro strips, and also have 2 mental D-rings for the attachment of carabiners or other equipment.

Rear of vest is double-ply mesh which allows for the addition of a hydration bladder.

Constructed of durable nylon mesh for maximum breathability



Macun Mahallesi Erciyes İşyerleri Sitesi 197. Cadde No: 11
Tel: 0312 473 79 21 • Faks: 0312 473 79 23
ozyigit@ozyigitteksstil.com


MAKİNE GIDA TURZ. İNŞ. VE PET. ÜR. PAZ. SAN. VE TİC. LTD. ŞTİ.
ANKARA
KURUMSAL NO: 281 011 1351 TİCARİ Sicil No: 151221
MERSİS NO: 08110111135100010

Foto 3: Fotot e materialit Nylon 6.6 me shtrese ngjitese PU



a) Kerkesat per aksesore

b) aksesoret e dorëzuar

c) mungojnë

Foto 4: Fotot e aksesoreve





Foto 5: Matjet te xhepave anësorë te jashtëm për GPS /Radio dhe xhepi i karikatorëve me gjerësi 13 cm dhe 9 cm,



Fotot 6: Matjet e xhepave tek pjesa e brendshme ,xhepat anësorë janë me gjatësi 21 cm (tejkalim 2 cm respektivisht 4 cm)



Fotot 7: Matjet e xhepave tek pjesa e brendshme ,xhepat qendror janë me gjatësi 36 cm (tejkalim 4 cm)



Foto 8: Foto e materialit te brendshem te produktit te ofertuar me shtrese PU/PVC.

Mbi bazën e argumenteve të paraqitura më lartë, me këtë rast, Parashtruesi i Ankesës kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që në përputhje me Nenin 111, paragrafi 3, të Ligjit për Prokurimin Publik, të marrë këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e “SSI Log” L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar dhe ekzistuese pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, me numër unik identifikues 810848765 dhe me seli në Rruga “Tahir Zajmi” 10000 Prishtinë;
- II. **ANULOHET** si i kundërligjshëm Vendimi Nr. 3-2/72/2026 i Ministrisë së Mbrojtjes, i datës 17 qershor 2026, me të cilin është refuzuar kërkesa e SSI Log L.L.C. dhe çështja kthehet në rishqyrtim pranë AK – Ministrisë së Mbrojtjes

9. Dëmet materiale

Përsbkruej mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakton ose kërvënobet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri tani demet e riparueshme kapin shumën prej 5,000 Euro, për shkak të shpenzimeve për mostrën dhe raportet testuese si dhe marrëveshjeve dhe shpenzimeve të avokaturës dhe shpenzimeve tjera të dalës për kompletimin e dosjes së kësaj lende duke e mos e kalkuluar fitimin e munguar në kjo kontrate.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksessbëm/ letrës për mospara-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

SHTOJCA NR. 1

AUTORIZIM I PËRGJITHSHËM

Sot më datën 1 qershor 2026, u paraqit personalisht dhe kërkoi përgatitjen e prokurës së mëposhtme, Pala si në vijim:

SSI LOG L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar dhe ekzistuese pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, me numër unik identifikues 810848765, me seli në adresën Rruga "Tahir Zajmi" p.n. 10000 Prishtinë, e përfaqësuar nga Pronarja Arjeta Qehaja Shkodra ("i Përfaqësuari"),

I Përfaqësuari lëshon këtë autorizim për:

- **Shkumbin Asllani** i lindur më 31.05.1990, Avoakt dhe Partner Menaxhues i Firmës Ligjore, INLEX Law Firm, me seli në Rr. Mark Isaku L1/A5, 10000 Prishtinë, Kosovë;
- **Edita Ismaili**, e lindur më 06.05.1996, Avokate pranë Firmës Ligjore, INLEX Law Firm, me seli në Rr. Mark Isaku L1/A5, 10000 Prishtinë, Kosovë;
- **Art Vula**, i lindur më 08.04.2000, Bashkëpunëtor ligjor pranë Firmës Ligjore, INLEX Law Firm, me seli në Rr. Mark Isaku L1/A5, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Në vijim të referuar kolektivisht si "**Përfaqësuesit**" ose individualisht si "**Përfaqësuesi**;"

Për të përfaqësuar së bashku ose individualisht, SSI Log L.L.C., më konkretisht, Përfaqësuesi ka të drejtën, përkatësisht është i autorizuar, në emër dhe për llogari të SSI Log L.L.C. pa kufizim:

1. Të përfaqësojë të Përfaqësuarin para: (i) secilës Gjykatë Themelore në Territorin e Republikës së Kosovës; (ii) Organit Shqyrtues të Prokurimit; (iii) çdo gjykatë tjetër, si Gjykata Komerciale, Gjykata e Apelit, Gjykata e Supreme, si dhe të ndjekë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e vendimeve gjyqësore si dhe (iv) përmbaruesve privat, duke ndërmarrë çdo veprim tjetër në vijim që lidhet me propozimet për përmbarim, lëshimin apo edhe ekzekutimin e aktgjyqësorëve dhe urdhrave të tjerë gjyqësorë, që lidhen me pagimin e detyrimeve ndaj Shoqërisë;
2. Të përgatisë, nënshkruajë, depozitojë, tërheqë në emër dhe për llogari të Përfaqësuarit, Propozim për Përmbarim, Kërkesë padinë, Përgjigjen në Padi si dhe çdo pretendim ose kërkesë të organeve gjyqësore, apelime, dhe çdo lloj kërkesë, kundërshtimi, prapësimi, padie, kundërpadie (civile), ankimi pranë Gjykatës së Apelit, dhe përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike pranë Gjykatës Supreme për proceset gjyqësore që lidhen me pagimin e detyrimeve ndaj Shoqërisë SSI Log L.L.C.
3. Të kryejë çdo veprim që e konsideron si të nevojshëm me qëllimin ndjekjen e procedurave gjyqësore në lidhje me Kërkesëpadinë në emër dhe për llogari të Përfaqësuarit, si dhe të gjitha të drejtat që i jep ligji si palë ndërgjyqësore, duke përfshirë por pa u kufizuar në, bërjen e

përmbledhjeve, pyetjeve, verifikimeve, të kërkojë paraqitjen e provave, të kthejë përgjigje veprimeve zyrtare, të kundërshtojë, të ndryshojë dhe/ose shtojë objektin e Kërkesëpadisë, të kërkojë zëvendësim të palës së paditur apo të pandehurit, etj, në proceset gjyqësore që lidhen me pagimin e detyrimeve ndaj Shoqërisë SSI Log L.L.C..

Ky autorizim përfshinë edhe punëtorët e tjerë të INLEX Law Firm, të cilët nuk janë të përmendur shprehimisht këtu dhe është i vlefshëm nga momenti i nënshkrimit të tij dhe për një periudhë të pacaktuar me të drejtë revokimi me shkrim në çdo kohë.

Të gjitha veprimet që do të kryhen nga Përfaqësuesit dhe/ose secili prej Përfaqësuesve konsiderohen të vlefshme dhe të rregullta sikur të ishin kryer nga SSI Log L.L.C.

Për llogari të
SSI Log L.L.C
Arjeta Qehaja Shkodra

